



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2 Prot.

Tepelenë, më 13.02.2026

PROÇES – VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot, më datë 13.02.2026, ora 10:30 në Pallatin e Kulturës Tepelenë (kati II- dytë) në mbledhjen jashtë radhë të Këshillit Bashkiak Tepelenë me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. **Projektvendim:** “Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese si dhe vlerës së bashkëfinancimit me qëllim përfitimin e fondeve nga programi i strehimit “Përmirësimi i banesave ekzistuese për vitin 2026”
3. Çështje të tjera

Kryetari i Këshillit Bashkiak, Z. Arben Gumeni, drejton mbledhjen. Ora e hapjes së mbledhjes: 10:30.

Këshilltarët pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Mjaftoni Zeraj, Besnik Maca.

Prezent nga Administrata e Bashkisë: Arta Shaha, Pellumb Hoxha.

**Kryetari i Këshillit, Z. Arben Gumeni:**

Përshëndet të pranishmit dhe hap mbledhjen jashtë radhë të Këshillit Bashkiak. Paraqet rendin e ditës dhe pyet anëtarët nëse janë dakord me të. Rendi i ditës hidhet në votim dhe miratohet me 12 vota pro.

**Pika e dytë e rendit të ditës: “Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese si dhe vlerës së bashkëfinancimit me qëllim përfitimin e fondeve nga programi i strehimit ‘Përmirësimi i banesave ekzistuese për vitin 2026’”**

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimit të projektvendimit.

**Fjalën e mori znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë:** Komisioni u mbledh sot dhe, pasi diskutoi edhe me aparatën e bashkisë mbi listat e familjeve, të cilat i keni edhe ju përpara si material, rezulton se bëhet fjalë për familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe persona me aftësi të kufizuar. Ju propozoj ta miratojmë këtë listë.



**Z. Vladimir Bakiaj:** Sa ka qenë numri i aplikuesve dhe sa kanë përfituar? Të gjithë që aplikuan u bënë pjesë e listës apo kishte dhe të tjerë që nuk u futën për shkak të kriterëve që duhet të plotësonin? Mund të kishte dhe reduktime, shikoj emra që nuk janë në kushte të vështira. Jam dakord që kjo listë të kalojë.

**Z. Pëllumb Hoxha, Sekretar për Emergjencat Civile:** Më datë 23.01.2026 në Bashkinë Tepelenë ka ardhur programi për përmirësimin e kushteve të banesave për familjet në nevojë. Është një program që realizohet në bashkëpunim me bashkinë dhe Ministrinë e Ekonomisë. U bë shpallja në faqen zyrtare të Bashkisë dhe aplikimet u bene pranë zyrave të bashkisë me kartë identiteti dhe certifikatë personale pronësie. Ky është kushti kryesor për aplikim për familjet që kanë probleme me përmirësimin e banesave.

Janë paraqitur 46 kërkesa dhe ne menduam t'i përfshijmë të gjitha. Ka pasur persona që kanë bërë kërkesë, por nuk kanë plotësuar kushtin kryesor, që është certifikata hipotekore e pronësisë. Të 46 kërkesat janë administruar nga Bashkia Tepelenë.

**Z. Vladimir Bakiaj:** Këta që janë skualifikuar nuk kanë pasur certifikatë?

**Z. Pëllumb Hoxha:** Po, nuk kanë pasur certifikatë pronësie. Gjithashtu, nuk lejohet kur në certifikatën familjare janë shumë persona dhe paraqitet kërkesa nga një person në emër të të tjerëve, kështu bëhet personale. Ka familje në nevojë, por pa certifikatë pronësie nuk mund të përfitojnë.

**Z. Vladimir Bakiaj:** Fondi është i përcaktuar?

**Z. Pëllumb Hoxha:** Fondi përcaktohet në bazë të preventivit. Për 46 kërkesa janë hartuar 46 preventivë. 40% e fondit do të bashkëfinancohet nga bashkia, në bazë të referencave të ardhura.

**Kryetari i Këshillit:**

Ka pyetje të tjera? Jo, Projektvendimi hidhet në votim:

**Vota PRO: 12**

Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Mjaftoni Zera, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Besnil Maça, Vladimir Gjonça., vota kunder s ka, abstenim s ka.

Ju faleminderit,

Mbyllet mbledhje e keshillit ora 10.45


**SEKRETARE E KËSHILLIT**

Valbona Çela



**KRYETAR I KËSHILLIT**

Arben Gumeni



Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelenë

web: [www.tepelena.gov.al](http://www.tepelena.gov.al)

E-mail: [info@tepelena.gov.al](mailto:info@tepelena.gov.al)